



# Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



<b>Për :</b>	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
<b>Cc:</b>	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së PËR: Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
<b>Nga:</b>	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 01/08/2018
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit të Komunës së Obiliqit	Nr.020-911
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendime	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktet e kuvendit të komunës në vijim:


Vendim Nr. 1-108 për shpallje me interes të përgjithshëm për shpronësim të Paluajtshmërive të cilat do të preken me rastin e ndërtimit të sheshit të Qytetit të Obiliqit;

Vendim Nr. 1-111 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 1-96 të datës 29.06.2018.

Të miratuara më datë: 31.07.2018

Të parashtruara për shqyrtim në MAPL më datë: 01.08.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të akteve të komunës si më sipër, vlerëson se aktet e komunës në aspektin procedural **janë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si të tilla mund të prodhojnë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za :	<b>Xhafer Gashi</b> , gradonačelnik Opštine Obilić <b>Burim Gërguri</b> , predsedavajući Skupštine opštine Obilić	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	<b>Ivan Todosijević</b> , ministar MALS-a <b>Rozafa Ukimeraj</b> , generalna sekretarka MALS-a	
Od:	<b>Shkelqim Jakupi</b> , rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština	Datum: 01/08/2018
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Obilić	Br. 020-911
Vrsta akta	Odluka	

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br.1-108 za proglašenje od opšteg interesa nepokretne imovine koja će biti eksproprisana prilikom izgradnje gradskog trga u Obiliću;
Odluka br.1-111 za stavljanje van funkcije Odluke br.1-96 od dana 29.06.2018. godine.
Usvojena dana, 31.07.2018.godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 01.08.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E OBILIQIT  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËR QYTETIN  
UPRADA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Datës-krizera

Nr. 1-108  
Br.

Data 31.07.2018  
Datuar

OBILIQ OBILIQ



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në bazë të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, neni 17 shkronja ( e ) nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40 të datës 4 qershor 2008, nenit 72, pika 1.8 e Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.1-34 i dt.25.04.2016,dhe nenit 39 të Rregullorës të punës së kuvendit , dhe propozimit (DUPK ) të Kryetarit të Komunës , Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.07.2018, mori këtë:

## V E N D I M

### PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMËRIVE TË CILAT DO TË PREKEN ME RASTIN E NDËRTIMIT TË SHESHIT TË QYTETIT TË OBILIQIT

- I. Aprovohet propozim i Kryetarit të Komunës , me Nr.II-156 t, i dt.30.07.2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e paluajtshmërive të pronave të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat do të preken nga projekti për ndërtimin e sheshit të qytetit në Obiliq , sipas listës së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik po ashtu dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij Vendimi.
- II. Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin .
- III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban,Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do të zhvilloj procedurat e shpronësimit.


- IV. Për zbatimin e tij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Drejtoria e Financave.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.


**KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT**

01-Nr. 108

Më datë. 31.01.2018

Kryesuesi i Kuvendit

  
Burim Gërguri





Delës tataro

Nr. 11-663  
Br.

Data 30.02.2018  
Datim

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Obiliq - Opštine Obilić - Municipality Obiliq

Në bazë të nenit 12.17 dhe 18.1 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40 të datës 4 qershor 2008, nenit 72, pika 1.8 e Statutit të Komunës së Obiliqit, nr. I-34 i dt. 25.04.2016, nenit 4,7 dhe 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës në Mbledhjen e radhës të miratojë këtë:

## PROPOZIM

### V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMËRIVE TË CILAT DO TË PREKEN ME RASTIN E NDËRTIMIT TË SHESHIT TË QYTETIT TË OBILIQIT

#### Neni 1

Të miratohet ky propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e paluajtshmërive të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat do të preken nga projekti për ndërtimin e sheshit të qytetit të Obiliqit, sipas listës së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale për tullalet e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik po ashtu dhe sipërfaqet e tyre.

#### Neni 2

Vlera e kompensimit për pronat që do të shpronësohen do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

#### Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij propozim Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadaster, Cjeodezi dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do të zhvilloj procedurat e shpronësimin.


#### Neni 4

Pas miratimit të këtij Propozim Vendimi për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Drejtoria e Financave.

#### Neni 5

Ky Vendim hyri në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolli të MAPI-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .





Qeveria - Vlada

Nr. -1-AAA

Data

31.07.2018

Datum

Qeveria - Vlada



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës dhe nenit 39 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së ligjshmërisë nga MAPL, me nr. 020-760/3, të dt.16.07.2018, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2018, mori këtë:

## V E N D I M


1. Shfuqizohet vendimi nr.1-96, i dt.29.06.2018, për ndarjen e parcelave sipas kërkesave të KEDS-it.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- DPUKP
- MAPL-së
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

Për :	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Date: 10/07/2018 Nr. 020-760
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1-96 për ndarjen e parcelave sipas kërkesë së KEDS-it.
I miratuar më datë më datë: 29.06.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.07.2018


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.



Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 1-96 për ndarjen e parcelave sipas kërkesë së KEDS-it.	Ky vendim nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Në bazë të certifikatës së pronësisë, me numër të lëndës 05.232018, njësia kadastrale me numër P-72614055-00866-0 si dhe lëndës me numër 05-1454/2018, evidentohen si Pasuri Shoqërore-Putevi dhe si të tilla nuk janë pronë e Komunës së Obiliqit. Bazuar në këtë, dhe duke ju referuar ligjit të lartshënuar, komuna nuk mund të japë në shfrytëzim pronën e paluajtshme e cila nuk është në pronësi të sajë.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Za :</b>	Xhafer Gashi, gradonačelnik Opštine Obilić Burim Gërguri, predsedavajući Skupštine opštine Obilić	
<b>Kopija</b>	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
<b>Preko:</b>	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-su	
<b>Od:</b>	Shkelqim Jakupi direktor Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština	Datum, 10.07.2018 Br. 020-760
<b>Predmet:</b>	Zahtev za ponovno razmatranje odluke Skupštine opštine	
<b>Vrsta akta:</b>	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 1-96 za podelu parcela prema zahtevu KEDS-a

Usvojena dana, 29.06.2018. godine,

Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 03.07.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog sadržaja akta opštine, procenjuje da je isti u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti

Br.	Formulisane u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka br. 23/18 za osnivanje Odbora za politiku i finansije.	Odluka br. 23/18 sa kojom je određen sastav Odbora za politiku i finansije od sedam (9) članova je u suprotnosti sa Zakonom br. 05/L-020 o rodnoj jednakosti zbog "Nejednake zastupljenosti žena u ovom pomoćnom telu rada Skupštine". Zakon br. 05/L-020 o rodnoj jednakosti u članu 6. tačka 7 i 8 je obavezalo da: "Zakonodavni, izvršni i sudski organi u svim nivoima kao i ostale javne institucije, obavezne su da usvajaju i sprovode posebne mere radi postizanja zastupljenosti manje zastupljenog roda, do postizanja jednake zastupljenosti žena i muškaraca. Jednako zastupljene u svim zakonodavnim, izvršnim i sudskim organima i ostalim javnim institucijama postiže se kada se obezbeđuje minimalno zastupljenje od pedeset (50) % za svaki rod uključujući i njihove odlučujuće i upravljačke organe" U vezi sa ovim pitanjem prethodno ste obavešteni pravnim dopisom MALS-a, br. 013-1515 od dana, 18.12.2017.

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od gradonačelnika i Skupštine opštine traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladile sa zakonskim odredbama na snazi i u određenom zakonskom roku od 30 dana, od dana primanja zahteva za razmatranje akta opštine. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



-1-96 29.06.2018



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Veçqeverisjen Lokale nr.031-000, (miratuar nga Zyrtari nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 19 të Rregullores së punës të Kuvendit, bazuar në Ligjin 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 10, pika 1.5, Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për ristet e vecanta, Rregullorja nr.23/20013, për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit dhe këmbimit të pronës së Paluajtshme të Komunës, Kapitulli IV, neni 20 të Besimiti Lokal të Komunës dhe në mbajtje të Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2018, mori këtë:

Stampa e Kuvendit Komunal Obiliq me datë 29.06.2018 dhe numër 0307/2018. Në këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës për ristet e vecanta, Rregullorja nr.23/20013, për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit dhe këmbimit të pronës së Paluajtshme të Komunës, Kapitulli IV, neni 20 të Besimiti Lokal të Komunës dhe në mbajtje të Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2018, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen kërkesat e DPUKP, me nr.V-561, të dt.12.06.2018, për ndarjen e parcelave sipas kërkesave të KEDS-it, 4675, të dt.01.03.2018 dhe kërkesa me nr.11923, të dt.17.05.2018, të cilat kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim pa kompenzim për parcelat me nr.00866-0, ZK Obiliq, Plemetin në hapësirë prej 20 m<sup>2</sup> dhe nr.00654-0, ZK Leshkoshiq P.SH. Rrugë pronë shoqërore, në hapësirë prej 9 m<sup>2</sup>.
2. Këto parcela ndahen për vendosjen e trafostacionit shtyllë dhe stabilimentit shpërndarës në kuadër të përforcimit të rejetit distributiv. Në këtë mënyrë do të bëhet furnizimi me energji elektrike dhe kualitative për banorët e fshatrave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kucilastri dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat e pronës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

- Ti dërgohet
- Kryetarit
  - Kryesuesit
  - Nënkryetarit
  - DPUKP
  - DSHPE
  - MAPL-së
  - Anëtarëve të Kuvendit
  - Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal  
*[Signature]*  
Burim Çerguri